



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 30/05/2025

PROCES VERBAL

Konsultimi Publik për Zgjedhjen e Anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme dhe Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës “Klubi i Futbollit Përmeti”

Vendi : Qendra Multifunksionale, Përmet

Ora : 11:00

Tema e konsultimit : Zgjedhja e Anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme dhe Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës “Klubi i Futbollit Përmeti”

I mbajtur sot më datë 30 Maj në sallën e konferencave të Qendrës Multifunksionale me temë kryesore futbollin. Të pranishëm janë Kryetarja e Bashkisë Përmet znj. Alma Hoxha, Nënkryetarja e Bashkisë Përmet znj. Aulona Meshini, Drejtoresha e Projekteve dhe Integrimit European znj. Klaudja Ciko, Përgjegjësi i Zyrës Juridike z. Enea Kushe, administrata e Bashkisë Përmet, përfaqësues të fushës së futbollit dhe qytetarë të interesuar.

Takimin e hapi Kryetarja e Bashkisë Përmet e cila e vlerësoi këtë takim si mjaft të rëndësishëm për të ardhmen e futbollit në qytet. Më pas falenderoi të gjithë futbollistët aktual të ekipit, pjesëtarët e stafit dhe në veçanti z. Gjergji Petro i cili ka kontribuar për futbollin përmetar për një kohë të gjatë. Në vijim të fjalës së saj znj. Hoxha dha lajmin e mirë se shumë shpejt do të fillojë rikonstrukcioni i Stadiumit në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Futbollit.

Më pas fjalën e mori Drejtoresha e Projekteve dhe Integrimit European znj. Klaudja Ciko e cila bëri një parantezë të situatës aktuale të futbollit në qytetin e Përmetit. Ajo shtoi se në bazë të ligjit 79/2017 Bashkia është përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve sportive si bazuar në ligjin 139/2015 institucionet vendore duhet të mbështesin aktivitetet e organizuara nga Federata. Gjithashtu znj. Ciko tregoi se edhe këtë vit futboli ashtu si edhe sportet e tjera u financuan nga Bashkia Përmet duke përdorur metodologjinë “Reload”.

Pas saj fjalën e mori z. Enea Kushe, Përgjegjës i Zyrës Juridike pranë Bashkisë Përmet i cili falenderoi të pranishmit për interesimin e tyre. Më pas u paraqiti Bazën Ligjore mbi të cilën do të funksionojë Shoqata “Klubi i Futbollit Përmeti”. Si fillim ai u tha se do të zgjidhën anëtarët e shoqatës të cilët do të jenë 5, me propozim të hapur e më pas po më votim të hapur. Në vazhdim anëtarët e zgjedhur do të mblidhen së bashku për të vendosur kush do të jetë Drejtori Ekzekutiv.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Në vijim të punës filluan dhe propozimet e emrave të anëtarëve nga komuniteti i futbollit të cilat ishin si më poshtë :

Viktor Peçi propozoi Avni Lapaj.
Heriald Karalliu propozoi Bledar Hajredini.
Sparti Dalipaj propozoi Bledar Hajredini.
Bledar Hajredini propozoi Shpresa Petro.
Jurgen Saliko propozoi Paulin Zhamo.
Paulin Zhamo propozoi Gentian Kreci.
Eduard Ibrahim propozoi Heriald Karalliu.

Pas mbylljes së propozimeve dhe votimit u përzgjedhën këta anëtarë :

1. Avni Lapaj
2. Heriald Karalliu
3. Gentian Kreci
4. Bledar Hajredini
5. Paulin Zhamo

Pasi përfundoi procesi i zgjedhjes së anëtarëve, znj. Alma Hoxha u uroi suksese në punën e tyre anëtarëve të sapozgjedhur dhe u kërkoi atyre bashkëpunim dhe përkushtim për të rikthyer futbollin përmetar aty ku i takon

Takimi u mbyll në orën **12:00**.

Konceptoi:
Koordinatori i Konsultimit Publik
Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

